REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 285/20
Datë/Datum. 01.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*
Hysni Muhadri: _____ *Valon Jahaj: Ekspert Teknik* _____	*21/05/2020*	*01/06/2020*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.05.2020, **OE "MULTI BUSINESS GROUP" SH.P.K. – Prizren**, i pakënaqur në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka parashtruar ankesën me nr: 285/20 kundër njoftimit për shpërblim me kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"622-19-8744-2-1-1"**, respektivisht atij me titull **"Efiqenca e ndriçimit puublik në Komunën e Prizrenit"-ritender**, iniciuar nga AK – **Kuvendi Komunal i Prizrenit.**

AK ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë të mesme, lloji i kontratës: shërbime, kontratë publike kornizë në kohëzgjatje 36 muaj, vlera e parashikuar e kontratës: **300,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së prokurimit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 12.11.2019
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 27.11.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 12.12.2019
Ankesa 1 në OSHP: 31.12.2019
Ekspertiza 1: 21.01.2020
Vendimi i PSH (lëndet 964 dhe 978-19): 12.02.2020
Njoftim per vendimin e AK-së: 28.02.2020
Ankesa 2. Në OSHP: 11.03.2020
Ankesa 3. Në OSHP: 16.03.2020
Ekspertiza për ankesat 2 dhe 3: 30.03.2020
Vendimi i PSH (lëndet 174 dhe 187-20): 07.04.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 22.04.2020
Kerkesa për rishqyrtim: 27.04.2020
Refuzimi i kërkeses për rishqyrtim: 30.04.2020
Ankesa në OSHP: 08.05.2020.

Pas pajisjes me autorizim me datë 21.05.2020, konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 të LPP-së, Eksperti Shqyrtues dhe ai Teknik i kanë shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "MULTI BUSINESS GROUP" SH.P.K. – Prizren, si palë e pakënaqur ne vendimin e AK-së dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me datë 08.05.2020, kanë parashtruar ankesë me nr.: **285/20** pranë OSHP-së. Me çrast OE ankues pretendon se gjatë procedurës së prokurimit AK ka shkelur nenet:
Nenin 1, Nenin 7, Nenin 59, Nenin 60, Nenin 69, Nenin 72 të LPP-së.
Si dhe Vendimet e OSHP-së: **174, 187-20 i dt. 07.04.2020 dhe 73, 80-20 i dt. 02.03.2020.**

Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar me daten 22.04.2020 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK ku na ka shpallur si tenderues te eliminuar, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë grupin e operatoreve ekonomik "NABS" SH.P.K. & N.T.SH. "ELING".
Fillimisht ju sqarojme se arsyeja e AK-së për eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit nuk qendron sepse ne si OE i plotësojme të gjitha kërkesat e kerkuara nga ana e AK-së kete e ka vertetuar edhe vete AK-ja në vendimin e mehershëm. Ne letrën Standarde qe na eshte derguar si OE i eliminuar eshte cekur se neve na mungon certifikata e garancionit 10 vjeçar te prodhuesit. Ju sqarojme se në vendimin e OSHP Nr.174,187/20 i dt. 07.04.2020 kerkohet dhe eshte sqaruar se AK mund ta kerkojë nga ne si informacion shtese këte garancion, por AK-ja nuk e ka perfille kete vendim. – **Pretendimi 1**

Ndersa AK-ja e ka shperblyer me kontrate Konzorciumin "NABS dhe Eling", perkunder faktit qe ky operator eshte i papergjegjshëm, duke e cilesuar edhe vete AK-ja në vlerësimet e kaluara si të tillë, kurse kete fakt e ka konstatuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-se me vendimin Nr. 73-80/20 i dt.02.03.2020 dhe gjithashtu edhe eksperti shqyrtues i OSHP-se, andaj tani me kete vendim të AK-së, nuk eshte respektuar vendimi i lartpërmendur i OSHP-se, sepse tani me pretendimi për pergjegjshmërinë e konzorciumit të rekomanduar për kontratë është çështje e gjykuar sipas nenit 105 paragrafi 2.16 të LPP-së dhe se i njëjti konzorcium në asnjë menyre nuk mund të shpallet i pergjegjshëm më. Sa i përket çështjes së deklarates nen betim shume qarte e ka konstatuar paneli shqyrtues në vendimin e mëparshem Nr. 73-80/20 i dt.02.03.2020 se nuk mund të kërkohen sqarime sepse ky dokument nuk ben pjese në dokumentet që parashihen të kerkohen sqarime e qe hynë deshmite prej nenit 65-71 të LPP-se, mirepo kete fakt e sqaron edhe me në detaj edhe interpretimi i KRPPP-së i dt.19.02.2020 në pyetjen Nr.72, tek pyetjet e shpeshta.
Pra sa i përket konzorciumit të rekomanduar per kontrate është shumë e qartë, eshtë konstatuar edhe me vendim të OSHP-së se është i papergjegjshem. – **Pretendimi 2**
Komisioni i fundit i autoritetit kontraktues ka kerkuar informata shtese nga konzorciumi NABS dhe Eling ne kundershtim me vendimin e OSHP-se dhe se ne baze të dokumenteve te ofruara e ka rekomanduar për kontrate kete konzorcium.

Konzorciumi i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshëm per arsyet si ne vijim:
*Ju sqarojme se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate eshtë i papergjegjshëm sepse deklaratën nën betim anetari i konzorciumit Eling nuk e kishte ofruar siç krkohet në FDT sepse e kishte ofruar kopje. Ndërsa tek neni 6.4 i FTD-së lidhur me Kerkesat e përshtatshmerisë: eshtë kërkuar në mënyrë decidive si në vijim "**Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në origjinal** ". Pra OE i rekomanduar për kontrate nuk ka plotësuar ketë kerkes të FTD-së, prandaj eshtë i papergjegjshëm.*
*AK ka kërkuar sqarime shtese në lidhje me deklaratën nen betim, mirëpo me asnjë dispozitë nuk lejohet që të kërkohet sqarime shtesë për deklaraten nën betim sepse kjo eshtë kërkesë e kualifikueshmërisë dhe si e tillë duhet të përmbushet me rastin e ofertimit sepse eshtë kërkuar në mënyrë decidive se duhet të jetë **origjinal**.*
Gjithashtu sqarimi i konzorciumit NABS dhe Eling eshtë absurd sepse dy deklarata të njëjta të skanuara me një vend nuk ka mundësi njëra të del origjinale e tjetra kopje. - **Pretendimi 3.**

Po ashtu AK ka kerkuar nga ky OE të sqaroj në detaje edhe listën e referencave dhe kontratave të paraqitura nga OE i rekomanduar sipas rekomandimeve të OSHP së.
*Ndersa në dosjen e tenderit eshtë kërkuar referenca të natyrë së kontratës të realizuar në tri vitet e fundit jo më pak se 450,00.00€. **Referencat** duhet të jenë të dëshmuara ne bazë të vlerës dhe natyrë së kontratës dhe*

procesverbal të pranimit përfundimtar të punimeve.
Ndersa konzorciumi i rekomanduar për kontrate në fjalë ka sjellur dokumente shtese por asgje nuk përkon më kushtet e kërkuara nga AK-ja. Ky konzorcium ka sjellur fatura dhe në asnjë moment nuk ka sjellur referenca apo situacion përfundimtar të punimeve. Për më tepër OE "NABS" ka sjellur një referencë ku ende nuk është përfunduar ajo kontratë dhe si e tillë ajo referencë nuk mund të merret për bazë. Fjala është për kontratën "Ndërtimi i mini parqeve, vendosja e ulëseve, koshave dhe ndriçimit dekorativ". Gjithashtu në këtë kontratë vetëm një pozicion është për ndriçim ndërsa pozicionet tjera nuk janë të natyrës së kërkuar ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.
Për me tepër faturat e sjellura si furnizues ndaj KEDS-it nuk jane në harmoni me natyrn e kontrates së ofruar. Efiçenca e ndricimit publik dallon nga punët e prezantuara nga operatori fitues në fjalë. Kjo pune eshte shume e nderlikuar kerkon njohuri, punë profesionale dhe specifike.
Prandaj konzorciumi i rekomanduar për kontratë është i papergjegjshem edhe në aspektin teknik profesional. - **Pretendimi 4.**

Ne dosje të tenderit eshte kërkuar certifikata e biznesit se bashku me informatat e biznesit, mirepo operatori ekonomik nuk e ka permbushur as kete kerkesë sepse nuk ka ofruar informatat mbi biznesin. - **Pretendimi 5.**

Ndersa ndriçuesit e ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontrate nuk jane ashtu sikur në paramase, nuk janë specifikuar në katalog me cilët ndriçues oferton firma, sepse ne katalogun e ofruar ka ndriçues të ndryshem, por jo edhe ashtu siç është e specifikuar në dosje të tenderit. - **Pretendimi 6.**

OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar certifikata te cilat nuk kanë asnje mundesi verifikimi, andaj AK-ja eshte dashur ti verifikoj dhe ti sqaroj siç duhet këto certifikata, po ashtu OE i lartpermendur nuk ka ofruar katalog per sistemin e menaxhimit te ndriçueseve, andaj nuk e plotëson as kete kerkesë , ne jemi të çuditur se si AK-ja ka mundur te rekomandojë për kontratë këtë OE i cili është i papergjegjshem. - **Pretendimi 7.**

Ne dyshojme edhe ne autorizimin e prodhuesit se eshte origjinal, prandaj kerkojme te verifikohet. - **Pretendimi 8.**

Operatori ekonomik "NABS SH.P.K. & ELING" në dokumentacionet e tij, ne katalogun e prezentuar nuk ka ofruar dëshmi për produktet, si në vijim: pajisjes për komunikim në mes të llambave dhe qasjes në Web site perkatës (GATEWAY-IT), kontrollerit inteligjent. - **Pretendimi 9.**

Nuk është marr parasysh (Kerkesa 4 a-Dëshmia 4 a) ku kërkohet që Operatori Ekonomik ta paraqes katalogun me produktet e ofruara, në katalog specifikat e produktit duhet të jenë të paraqitura dhe lehtë të verifikueshme. - **Pretendimi 10.**

Operatori ekonomik "NABS" SH.P.K. & "ELING" është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ka paraqitur listën prej 11 të të punësuarve, por nuk ka prezentuar edhe dëshmitë e kualifikimit profesional-diplomat për secilin prej tyre, ai në fakt ka prezentuar vetëm 3 kualifikime profesionale-diploma nga 10 punëtorët e prezentuar. Ndërsa për njërin nga punëtorët, i cili gjendet në listën e të punësuarve nuk ka prezentuar as dëshminë e kualifikimit profesional-diplomën, as kontratën e punës dhe as përvoja e punës për këtë punëtor nuk figuron askund. Dëshmitë mbi kualifikimin e stafit-diploma, përvoja në punë, kontratat e punes janë në mënyrë precize të kërkuara për secilin punëtor sipas dosjes së tenderit. (Kërkesa 2 b-Dëshmia 2 b). - **Pretendimi 11.**

Nuk është prezentuar referenca për menaxherin e kontratës, ashtu si është përcaktuar me kriterin në dosjen e tenderit Kërkesa 2 a –Dëshmia 2 a. Të gjitha kontratat që kompania "NABS" SH.P.K. & "ELING" i ka lidhë me punëtorët e saj dhe që i ka prezentuar si dokumente janë pa nënshkrime të vet punëtorëve. Prandaj, nuk janë valide këto kontrata. - **Pretendimi 12.**

Duke pasur parasysh faktet e lartpermendura, rezulton se konzorciumi i rekomanduar për kontrate në ketë aktivitet të prokurimit është pale pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, perkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyre me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në

asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.
Ne pajtohemi plotesisht me vlerësimin e AK se operatorët ekonomik tjer janë të papergjegjshëm dhe në kete rast vetëm ne jemi ofertues që i plotësojmë të gjitha kërkesat FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.
Gjithashtu ju sqarojme se dy komisione të ndryshme të autorizuar nga Komuna e Prizrenit na ka rekomanduar si fitues të mundshëm për këtë aktivitet të prokurimit.
Vlen të theksohet qe komisioni i tretë eshtë komision jo profesional sepse për vlerësim të tenderit janë zgjedhur punetore Teknik. Ata nuk kanë kompetencë profesionale dhe se puna e tyre e perditshme në këtë komision bien ndesh me natyrën e punës së tyre. Natyra e vleresimit të këtij tenderi është komplekse dhe tepër e ndërlikuar gjë që nuk përkon me detyrat dhe pergjegjësite e punetoreve në fjalë.
Ne me dt. 30.04.2020 kemi marrë përgjigje në kerkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kerkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.
Në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se AK nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore por me arsyen të cilën e ka dhënë se informatat shtesë që i ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë vetëm sa i ka mbështetur pretendimet tona ankimore, sepse ne e kemi cekur shumë qartë dhe gjithashtu këtë e ka konstatuar edhe paneli shqyrtues në vendimin e mëparshëm Nr. 73-80/20 i dt.02.03.2020 se nuk mund të kërkohen sqarime sepse dokumenti i lartpërmendur nuk ben pjese në dokumentet që parashihen të kërkohen sqarime e qe hynë dëshmite prej nenit 65-71 të LPP-së, mirëpo këtë fakt e sqaron edhe më në detaje edhe interpretimi i KRPPP-së i dt.19.02.2020 në pyetjen Nr.72, tek pyetjet e shpeshta.
Ndërsa sa i përket arsyes tjetër për eliminimin tonë ku AK-ja e ka cekur se të gjitha veprimet e ndërmarra me rivlerësimin e ofertave kanë qene dhe janë në përputhje me vendimin e OSHP-së lidhur me këtë projekt, ne ju sqarojmë se si mund të jetë ky vendim i AK-së në përputhje me vendimin e OSHP-së ku shihet qartë se paneli shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë tani është i papergjegjshëm ndërsa ju përsëri e keni favorizuar duke e rekomanduar për kontrate dhe duke na diskriminuar neve si OE i pergjegjshëm.
Gjithashtu AK nuk i ka shqyrtuar pothuajse asnjë pretendim tonin, gjë që tregon se pretendimet tona të lartpërmendura qëndrojnë dhe janë të sakta.
Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën me lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.
Gjithashtu nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor për dhenie të kontrates e që ka qenë ***tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet*** *siç parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.*
Po ashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse ka favorizuar OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa na ka diskriminuar neve.
Gjithashtu AK është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET*, si e bazuar ankesa e OE* ***"Multi Business Group" SH.P.K.***
ANULOHET, *njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhenie të kontrates dhe lënda kthehet ne* ***RIVLERËSIM,***
DETYROHET *AK që gjatë rivleresimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave të behet ne harmoni me kerkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave të LPP.*
Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojme procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Fakti 1. Kerkesa për informacione shtesë nga eksperti drejtuar AK-së

Ankesa 285-20
2 messages

Valon Jahaj <valonjahaj@gmail.com> Thu, May 21, 2020 at 1:42 PM
To: Isa Osmankaj <isa.osmankaj@rks-gov.net>
Cc: Hysni Muhadri <hysni.muhadri@rks-gov.net>

Pershendetje z.Isa,

Nese keni mundesi ma dergo komplet korespondencen e bere (emailat kerkesat per sqarime shtese apo dokumente plotesuese) me OE pas vendimit te OSHP-se 174-187-20.
Eshte fjala per proceduren e prokurimit "622-19-8744-2-1-1", respektivisht atij me titull "Efiqenca e ndriçimit puublik në Komunën e Prizrenit"-ritender, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Jam i caktuar si ekspert i jashtem teknik.

me respekt,
Valon Jahaj

Isa Osmankaj <Isa.Osmankaj@rks-gov.net> Fri, May 22, 2020 at 12:05 PM
To: "Valon Jahaj (valonjahaj@gmail.com)" <valonjahaj@gmail.com>

From: Isa Osmankaj
Sent: 2020-05-22 11:59.PD
To: 'Valon Jahaj'
Subject: RE: Ankesa 285-20

Përshëndetje Valon. Po ua dërgoj në attach

1. Pamjen e kërkesës së dëguar me email për informata shtesë
2. Letrën standarde për dokumentet e kërkuara shtesë

3. Dokumentet e dërguara nga ana e OE për këtë Projekt do ti dërgoj me wetransfer sepse me email në outlook nuk po ban për shkak të kapacitetit

Me nedrime

Isa Osmankaj

[Quoted text hidden]

---

2 attachments

Kërkesa për NABS.PDF
123K

B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Nabs) 1.docx
41K

Fakti 2, Kërkesa e AK-së për sqarime shtesë drejtuar grupit te OE "NABS dhe Eling".

Njoftim; leter standarde

Zyra e Prokurimit Prizren <prokurimipz@hotmail.com>
Tue 4/21/2020 11:46 AM
To: nabs_shpk@hotmail.com <nabs_shpk@hotmail.com>

1 attachments (42 KB)
B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Nabs) 1.docx;

Përshëndetje në atach keni kërkesën për informata shtesë
me nderime
Isa Osmankaj

Fakti 3, pjesë nga raporti i rivlerësimit te tenderit, i datës 22.04.2020, "kërkesat administrative"

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË ADMINISTRATIVE të TENDERËVE

Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik

	Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit										
	Identifikimi i qartë i tenderuesit										
		Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik									
	TENDERUESI (Emri, Adresa, Numri fiskal)	Deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkëngjitur dhe individualisht përgjegjës	Deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Deklarata e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si dhënë	Origjinali i tenderit dhe kopja	Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit	Vlefshmëria e tenderit 120 ditë / muaj / data deri	Deklarata e cila deklaron mënyrën e bashkëngjitjes e zgjedhur	Kërkesa të tjera formale/administrative (si specifikohen)	TENDERI I PËRGJEGJSHËM ME KËRKESAT ADMINISTRATIVE POJO
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik EVERLIGHT SH.P.K.; H & B - Consulting SH.P.K. Fazli Bala Emshir PRISHTINË	Po	Po	Po	Po	Po	Po	150 ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Po

030 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

2

2.	" Termovision " SH.P.K. Q. T. Dard. Te P. e Re Z. Veri N. A Lok. nr24. PRISHTINË 600147864				Po	Po	Po	150 ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Po
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik NABS SH.P.K.; N.T.SH. Eling Luan Haradinaj Sol 1 Hy 1 Nr.4. Prishtinë	Po	Po	Po	Jo	Jo	Po	150 ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Jo
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik AFIONI SH.P.K. „Elektrostubla Sh.p.k. Ilaz Kuka 21, PRIZREN	Po	Po	Po	Po	Po	Po	150 ditë / muaj / data deri	Po		Po
5.	Multi Business Group SH.P.K. JUSUF GËRVALLA 103 K.II. PRIZREN 811033258				Po	Po	Po	150 ditë / muaj / data deri	Nuk kërkohet		Po

Fakti 4, pjesë nga raporti i rivlerësimit i datës 22.04.2020, "përshtatshmëria administrative"

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	Grup i Operatorëve Ekonomik EVERLIGHT SH.P.K.; H & B - Consulting SH.P.K.	
2.	" Termovision " SH.P.K. 600147864	
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik NABS SH.P.K.; N.T.SH. Eling	Deklarata nenbetim e Oe: Eling eshte kopje e scanuar jo origjinale
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik AFIONI SH.P.K.; „Elektrostubla Sh.p.k.	
5.	Multi Business Group SH.P.K. 811033258	

Fakti 5, Rekomandimi i PSH për AK-në sipas vendimit të OSHP-së nr. 174-187_20

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AFIONI" SH.P.K. dhe "ELEKTROSTUBLLA" SH.P.K. se AK ka shkelur kriterin e dhënie së kontratës ngase nuk është përzgjedhur oferta me çmimin më të ulët. Më tej, OE ankues shton se zyrtari i prokurimit në përputhje me nenin 72 ka mundur të kërkoj sqarime për cilindo dokument në të cilin ka pasur mos njohuri nga ana e komisionit vlerësues apo mangësi në informata dhe me këtë rast do të përfilleshin qëllimet dhe procedurat e LPP-së në mënyrë që të kursceheshin afërsisht 17,410.00Euro. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik sqaron se AK ka bërë shkelje te këtij neni dhe është dashur që nga OE i rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë, gjatë procesit të kërkesave se informacioneve shtesë të kërkoj edhe deklaratat për garancinë dhe përkrahje me pjesë rezervë, deklarata këto të cilat i mungojnë. Kurse, sa i përket pretendimit të OE ankues se oferta e tij është më e lirë në shumë prej 17,410.00Euro dhe kjo shumë do të kursehej, Paneli Shqyrtues ka dhënë sqarimet më lartë se cilat kritere nuk i ka përmbushur. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Fakti 6, Interpretimi i "pyetjeve të shpeshta" respektivisht asaj nr. 72 nga https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=268

72. 19.02.2020. A duhet kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës. në rast se Operatorët Ekonomik nuk e dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre "Deklaratën nën betim"?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar nga palët e i interesit, KRPP sqaron si në vijim:

Për dokumentacion dhe ofrimin e sqarimeve shtesë flet neni 59 dhe neni 72 i LPP-së.

Në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të, që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë deshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Ndersa paragrafi 3 i nenit 72 të këtij ligji përcakton si në vijim:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet ***vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***

"Deklarata nën betim" është kusht administrativ dhe deshmi që kërkohet sipas nenit 65 të LPP-së për të deshmuar përshtatshmërinë e OE-së për pjesëmarrje në aktivitetin aktual të prokurimit (pra që është në fazën e tenderimit) dhe si e tillë ajo nuk mund te kërkohet në bazë te nenit 72 te LPP-ës, ngase ekzistenca e saj (pra e deklaratës nën betim) nuk mund te verifikohet ne mënyre objektive nga AK siç e kërkon paragrafi 3 i nenit 72 te LPP-ës.

Pra me një fjalë, deklarata nën betim **nuk** është një dokument i cili e plotëson kërkesën e paragrafit 3 te nenit 72 te LPP-ës, për këtë arsye, **Deklarata nën betim, duhet të nënshkruhet vuloset dhe** duhet te dorëzohet së bashku me tender para afatit te fundit për dorëzimin e tenderëve te specifikuar ne Dosjen e Tenderit.

Fakti 7, për Pretendimin 4, "Kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale"

		Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kërkes 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e fundit ,e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogës se 450.000,00 €**	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, kurse kopje për dosien në kopje fizike, të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të punëve (kopje).**

Fakti 8, për Pretendimin 8 – Komunikimi i Ekspertit me prodhuesin e trupave ndriçues LED.

Request for information!
3 messages

Valon Jahaj <valonjahaj@gmail.com> Tue, May 26, 2020 at 2:41 PM
To: info@zgsm-china.com, rain@zgsm-china.com

Dear Sirs,

First of all I hope that you and your families are fine and in perfect health in this time of virus!

I need from you some information about your representative in Kosovo, I am independent technical expert to whom is assigned a case of dispute between one of our Municipalities and one economic operator. This case is assigned to me by "Kosovo Procurement Body", one of the claims of the Economic Operator who made an appeal at this Body is that he believes that the attached document is not original and that your company is not supporting "NABS" SHPK for this procurement procedure.

Can you please check an advise to me the authenticity of the document and who is your partner for our Country or for this region.

Your answer will help me a lot on bringing and proposing fair judgment on this matter!

Best regards,
Valon Jahaj

11. Autorizimi dhe deklerata.PDF
105K

ZGSM Tech <info@zgsm-china.com> Wed, May 27, 2020 at 6:09 AM
Reply-To: info@zgsm-china.com
To: Valon Jahaj <valonjahaj@gmail.com>
Cc: rain@zgsm-china.com, nelson@zgsm-china.com, 陈中万 <karen@zgsm-china.com>

Dear Valon,

Nice to meet you, It's Nelson, sales manager of ZGSM Tech.
Thank you for your wishes, I hope you and your families are also be healthy from viruses.
"NABS" SHPK indeed is our representative in Kosovo for the tender of LED Street Light, your attached Authorization is ture. We hold the original ones in hand.
And we also support "NABS" SHPK for this procurement procedure, but ONLY for ZGSM Brand LED Street Light, please noted.
Attached is the specs of LED Street Light we offered for this tender.
Any other questions, please feel free to let me know.

Best Regards,

NELSON CHEN
SALES MANAGER

ZGSM
SAVE TODAY'S ENERGY FOR TOMORROW

+86 150 6875 8485 / nelson@zgsm-china.com
Skype: zgsmled

HANGZHOU ZGSM TECHNOLOGY CO., LTD
1188 JINXI SOUTH ROAD, LIN'AN 311301, HANGZHOU, ZHEJIANG, CHINA.
ZGSM-CHINA.COM

Fakti 9, për Pretendimin 5 të OE ankues, Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje).** **Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal** **Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së**

Fakti 10, për pretendimet 6 dhe 10 të OE ankues:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 4 a.Katalogun e produketev .**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmija 4 a.Ne piken a , OE duhet te paraqes katalogun me produktet e ofruar, ne katalog specifikat e produktit duhet te jene te paraqituara dhe lehte te verifikueshme .**

Aneksi 1. i DT "SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME"

Llamba kompakte të LED teknologjisë

- Mirëmbajtje të lehtë
- Llamba në pjesën e poshtme të mos ketë xham në mënyrë që të ketë ftohje efikase; me ajrosje natyrale
- Të ketë logo të gravuar të prodhuesit në shtëpizë të llambës
- Llamba të jetë me module të pavarura, në mënyrë që ndërrimi eventual i tyre të jetë i pavurur
- Mbërthyes të cilët nuk koorodohen
- Mbrojtje mekanike; IP66
- Qëndrueshmëri: ≥ 100 000 (h/pune)
- Efikasiteti i ndriçueshmërisë së LED-it: ≥ 160 lm/W
- Temperaturë të ngjyrës: ≤ 4000 K
- Tension pune: 100...260 V (50Hz)
- Faktor të fuqisë: ≥ 0.95
- Temperaturë pune: (-40 ...+55)°C
- Ftohja: me rrymim natyral të ajrit
- Mundësi për montim horizontal dhe vertikal dhe me kënd të rrotullimit prej +/- 15
- Libelë të integruar për pozicionim të llambës
- Të posedoi mbrojtje nga mbitensioni (rrufeja) prej 10 kA.
- Mbrojtje në goditje: ≥ IK10
- Garanci: ≥ 10 vite

Llamba nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet ti plotësoj standardet Evropiane sipas direktivave të BE: CE, ENEC, IEC përkatësisht: EN 62471:2008, EN 62493:2015, EN 60598-1:2015/A1:2018, EN 60598-2-3:2003/A1:2011, EN 60529:1991/A2:2013, IEC 60598-2-3:2002
IEC 60598-2-3:2002/AMD1:2011, IEC 60598-1:2014, IEC 60598-1:2014/AMD1:2017,IEC 62471:2006, IEC 60529:1989/A2:2013, IEC/EN 62262:2002, IEC/EN 60068-2-75:2014

Fakti 11, Paramasa nga DT:

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE EFIQENCA NË NDRIÇIM PUBLIK NË KOMUNËN E PRIZRENIT					
Nr. Rend	Pershkrimi i punimeve dhe materialt per furnizim	Njesia	Sasia Copw	Çmimi (€/njwsi	Gjithsej (€)
1	Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë me lira në shtyllat ekzistuese. LED 50W	cope	300		-
2	Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë me lira në shtyllat ekzistuese.LED 100W	cope	300		-
3	Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë me lira në shtyllat ekzistuese. LED 150 W	cope	200		-
4	Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë me lira në shtyllat ekzistuese. LED 200 W	cope	200		-
5	Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë me lira në shtyllat ekzistuese. LED 240 W	cope	40		-
6	Furnizimi dhe vendosja e pajisjes për komunikim në mes të llambave të vendosura dhe çasjes në Web site përkatëse. Nëse të dhënat përcillen me anë të valëve të telefonisë mobile, atëher OE përfitues i këtij tenderi, bën parapagimin për shfrytëzim 3 vjeçar për të gjitha kartelat e vendosura	cope	40		-
7	Furnizimi , vendosja dhe aktivizimi i portit (bazes) per kontrollerin intelegjent NEMA SOKET .	cope	1.040		-
8	Furnizimi dhe montimi i kontrollerit intelegjent per menaxhinin e ndriçimit publik NEMA SOKET .	cope	1.040		-
9	Furnizimi dhe instalimi i softuerit aplikativ në laptop (kompatibil me softuerin dhe harduerin e llambave të ofruara) për monitorim, menaxhim (kontrollim) inteligjent, kalkulim dhe pasqyrim qendror nga distanca. Po ashtu, furnizimi, instalimi dhe konektimi i të gjitha pajisjeve tjera të nevojshme për kompletim të pajisjes së lartpërmendur	cope	1		-
10	Demontimi i lirës dhe llambës ekzistuese në të gjitha llojet e shtyllave dhe bartja e tyre deri në depo	cope	1240		0,00
11	Furnizimi dhe montimi i lirës për LED llambë (armaturë) me krah 1.0 m. Lira të jetë mirë e lakuar pa u dëmtuar, për 85...90° si dhe e zinkuar. Lira të jetë me dimension standard për mbërrthim të LED llambës. Po ashtu të bëhet edhe furnizimi pajisjeve të nevojshme mbërthyese për montim të lirave në shtylla të drurit, betonit apo të metalta	cope	1240		0,00
12	Furnizimi dhe montimi i kabllos për furnizim të llambës me energji elektrike; NYY/J 3X1.5mm²	m'	3120		0,00
			TOTALI :		0,00

Fakti 12, për pretendimet ankimore 11 dhe 12 te OE ankues:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 2 a.Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar elektros ose master me jo më pak se 3 vite pune në profesion.** **b. Në kuadër të stafit të punës duhet të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmija 2 a. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për tri vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt,** **b. Nën pikën b dëshmi mbi kualifikimin e stafit diplomat, përvoja në punë , kontratat e punës ose kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.**

Këto fakte janë shfrytëzuar nga ana e eksperteve shqyrtues për shqyrtimin e të gjitha pretendimeve ankimore te OE ankues dhe dhenien e rekomandimeve per Panelin Shqyrtues.

4. RAPORTI I KOMISIONIT RIVLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e pa**rashtruar nga OE "MULTI BUSINESS GROUP" SH.P.K. – Prizren me nr. 285/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit** numër **"622-19-8744-2-1-1"**, respektivisht atij me **titull "Efiqenca e ndriçimit puublik në Komunën e Prizrenit"- ritender"**, iniciuar nga AK – **Kuvendi Komunal i Prizrenit.**

Raporti i rivlerësimit është përgaditur me datën 22.04.2020.
Anëtaret e komisionit rivlerësues:

1. Ahmet Pulaj
2. Galip Belallari
3. Albert Oreshka.

Gjithsejtë kanë qenë pesë (5) oferta të dorëzuara nga OE, si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Tenderuesi	Çmimi (me TVSh)
1.	**Grup i Operatorëve Ekonomik: "AFIONI" SH.P.K. dhe "Elektrostublla" Sh.p.k., Iliaz Kuka 21, 20000, PRIZREN**	**278,000.00**
2.	**"Termovision" SH.P.K., Q. T. Dard. Te P. e Re Z. Veri N. A Lok. Nr. 24, 10000, PRISHTINË**	**237,736.00**
3.	**"Multi Business Group" SH.P.K., JUSUF GËRVALLA 103 K.II, -, PRIZREN**	**295,410.00**
4.	**Grup i Operatorëve Ekonomik: "EVERLIGHT" SH.P.K. dhe :H & B – Consulting" SH.P.K., Fazli Balaj Emshir, 10000, PRISHTINË**	**226,900.00**
5.	**Grup i Operatorëve Ekonomik: "NABS" SH.P.K. dhe N.T.SH. "Eling", Luan Haradinaj Sol 1 Hy.1 Nr.4, 10000, Prishtine**	**238,152.30**

Ku për tu shpërblyer me kontratë është propozuar grupi i **OE "NABS" SH.P.K. dhe N.T.SH. "Eling", Prishtinë me çmim të përgjithshëm 238,152.30 eur me TVSH të përfshirë.**

Oferta e OE "Afioni SHPK dhe Elektrostublla" SHPK është refuzuar për këto arsye:
Arsye 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e fundit, e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogës se 450.000,00 €
Arsye 2. c. Certifikata ISO 90001 e prodhuesit per produktet e ofertuara. d. Certifikata ISO 140001 e prodhuesit te produkteve, e. Certifikata ENEC per produktet e ofertuara, f. Certifikata Iec per produktet e ofruara.

Oferta e OE ''Termovision'' është refuzuar për këto arsye:
Arsye 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e fundit ,e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogës se 450.000,00 €
Arsye 2 a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar elektros ose master me jo më pak se 3 vite pune në profesion. (mungon diploma dhe CV e menaxherit te projektit)
d. Ceritifikata ISO 140001 e prodhesit te produkteve . e. Certifikata ENEC per produktet e ofertuara . f. Certifikata IEC per produktet e ofertuara certifikates ENEC , ne qertifikatat duhet te jene te precizuara produktet me numer identifikuaes sipas katallogut te ofruar si dhe te jen te testuara sipas EN 62471 2008 EN 62493 2015 EN 60598-1 2015 A1 2018 EN 60598-2-3 2003 A1 2011 EN 60529 1991 A2 2013 f. Kopja e certifikates IEC , ne qertifikat duhet te jene te precizuara produktet me numer identifikuaes sipas katallogut te ofruar si dhe te jen te testuara sipas IEC 60598-2-3 2002 IEC 60598-2-3 2002 AMD1 2011 IEC 60598-1 2014 IEC 60598-1 2014 AMD1 2017 IEC 62471 2006 IEC 60529 1989 A2 2013 IEC EN 62262 2002 IEC EN 60068-2-75 2014.

Oferta e OE "MBG" është refuzuar sepse sipas vendimit të OSHP-së i mungon garancioni 10 vjeqar i prodhuesit.

Oferta e OE ''Everlight'' SHPK dhe ''H & B Consulting'', është refuzuar për këto arsye:
Arsye 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e fundit ,e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 450.000,00 € (ne listen e paraqitur te kontratave

nuk ka projekte te natyres se kontrates).
Arsye 2. d. Ceritifikata ISO 140001 e prodhesit te produkteve. e. Certifikata ENEC per produktet e ofertuara . f. Certifikata IEC per produktet e ofertuara certifikates ENEC , ne qertifikat duhet te jene te precizuara produktet me numer identifikuaes sipas katallogut te ofruar si dhe te jen te testuara sipas EN 62471 2008 EN 62493 2015 EN 60598-1 2015 A1 2018 EN 60598-2-3 2003 A1 2011 EN 60529 1991 A2 2013 f. Kopja e certifikates IEC , ne qertifikat duhet te jene te precizuara produktet me numer identifikuaes sipas katallogut te ofruar si dhe te jen te testuara sipas IEC 60598-2-3 2002 IEC 60598-2-3 2002 AMD1 2011 IEC 60598-1 2014 IEC 60598-1 2014 AMD1 2017 IEC 62471 2006 IEC 60529 1989 A2 2013 IEC EN 62262 2002 IEC EN 60068-2-75 2014

Rekomandimi i komisionit rivlerësues të aktivitetit të prokurimit pranohet nga ana e zyrtarit përgjegjës të Prokurimit pranë AK-së dhe i njejti raport nënshkruhet me datë 22.04.2020.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

1. Lëndet 964 dhe 978 - 2019, *gjegjësisht* ***ankesa e OE "NABS" SH.P.K dhe N.T.SH. "ELING" si dhe ankesa e OE "Everlight" SH.P.K. dhe H and B Consulting – Prishtinë,*** *Vendimi* ***964-978 – 2019,*** *ku aprovohen nga ana e P.SH. të OSHP-së si të bazuara ankesat dhe proceduren e prokurimit Paneli Shqyrtues e kthen në rivlerësim me vendim të datës 12.02.2020.*
Në dispozitiv të vendimit thuhet se vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 te LPP-së dhe njekohësisht e obligon AK-në që gjatë procedurës së rivlerësimit të veproj konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të verifikojë dhe të kërkoje sqarime shtesë nga OE lidhur me kërkesat e përcaktuara në DT dhe njoftimin për kontratë.

2. Lëndet 174 dhe 187 – 2020, *gjegjësisht ankesat e* ***OE "NABS" SH.P.K dhe N.T.SH. "ELING" – Prishtinë dhe OE "AFIONI" SH.P.K. dhe "ELEKTROSTUBLLA" SH.P.K. – Prizren,*** *Vendimi 174-187-20, ku ankesat aprovohen si e bazuar dhe si pjesërisht e bazuar dhe obligohet AK që proceduren ta kthejë ne rivlerësim.*
Në dispozitiv të vendimit thuhet se AK gjatë vlerësimit te ofertave nuk ka arritur të bejë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tendereve konform kërkesave të DT dhe njoftimit për kontratë që është në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, sepse paneli e kishte obliguar AK që të kërkonte sqarime shtesë, kurse AK nuk e kishte bërë nje gjë te tillë. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se AK duhet ta ketë parasysh nenin 1 të LPP-së pasi që dihet qëllimi i këtij neni.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE ANKIMORE

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, dokumenteve te bashkangjitura gjatë aplikimit dhe ato të kërkuara si informacione shtesë dhe sqaruese nga ana e AK-së, eksperti shqyrtues dhe ai teknik japin këto konstatime në pretendimet ankimore te OE ankues:

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 1:
...Ne letrën Standarde qe na eshte derguar si OE i eliminuar eshte cekur se neve na mungon certifikata e garancionit 10 vjeçar te prodhuesit. Ju sqarojme se në vendimin e OSHP Nr.174,187/20 i dt. 07.04.2020 kerkohet dhe eshte sqaruar se AK mund ta kerkojë nga ne si informacion shtese këte garancion, por AK-ja nuk e ka perfille kete vendim.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të fakteve dhe informacioneve për **pretendimin 1** duke u bazuar në faktin 5 të kësaj ekspertize, konsideron se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 72 të LPP-së dhe nuk i është përmbajtë ne plotni rekomandimit te P.SH. të OSHP-së, konkretisht Vendimit 174-187-2020, duke kërkuar informacione shtesë vetem nga OE i rekomanduar për kontratë nga komisioni rivlerësues, kjo deshmohet edhe me faktet 1 dhe 2 të kësaj ekspertize, andaj ketë pretendim te OE ankues e cilësoj **si të Bazuar** dhe si të tillë i'a rekomandoj qe të aprovohet edhe nga P.SH. i OSHP-së. Prandaj me këtë rast nuk është respektuar neni 7 i LPP-së dhe nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimet ankimore 2 dhe 3:
...OE i rekomanduar i papergjegjshem dhe deklarata nën betim e njerit anetar te konzorciumit kopje e skanuar e origjinalit, si dhe sqarimi i KRPPP-së i dt.19.02.2020 në pyetjen Nr.72, tek pyetjet e shpeshta.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të fakteve dhe informacioneve për **pretendimet 2 dhe 3** dhe bazuar në faktin 6 të bashkangjitur kësaj ekspertize konstaton se Deklarata nën betim është kerkesë e domosdoshme administrative që kerkohet kopje e origjinalit dhe e njëjta nuk është e lejuar të jetë subjekt i kërkesave për informacione shtesë si dhe duke u bazuar edhe në faktet 3 dhe 4 po ashtu të bashkangjitura në ekspertizë, ku shihet konstatimi i komisionit rivlerësues te AK-së që OE i propozuar për kontratë është i papërgjegjshem administrativisht dhe është e cekur decidivisht që: "Deklarata nën Betim e OE Eling – Kopje e skanuar jo origjinale" dhe i njejti OE është rekomanduar dhe pastaj edhe është aprovuar për tu shpërblyer me kontratë, andaj duke u bazuar në këto fakte konsideroj se pretendimet 2 dhe 3 te OE ankues janë Bazuara dhe i rekomandoj P.SH. të OSHP-së që ti aprovoj **si të Bazuara.** Pra AK-ja edhe vetë e ka konstatuar gjatë rivlerësimit se është i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa përsëri e ka rekomanduar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 4:
Po ashtu AK ka kerkuar nga ky OE të sqaroj në detaje edhe listën e referencave dhe kontratave të paraqitura nga OE i rekomanduar sipas rekomandimeve të OSHP së.
Ndersa në dosjen e tenderit është kërkuar referenca të natyrë së kontratës të realizuar në tri vitet e fundit jo më pak se 450,00.00€. ***Referencat*** *duhet të jenë të dëshmuara ne bazë të vlerës dhe natyrë së kontratës dhe* ***procesverbal të pranimit përfundimtar të punimeve.***

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të fakteve dhe informacioneve për **pretendimin 4** duke u bazuar në faktet 1 dhe 7 të bashkangjitura kësaj ekspertize dhe në Pikat 9.1 & 9.2 të DT "Kapaciteti teknik dhe profesional": ***Kërkes 1.*** *Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e fundit, e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit standardeve, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 450.000,00 €.*
Dëshmia 1: *Lista e projekteve te ngjashme vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, kurse kopje për dosien në kopje fizike, të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të punëve (kopje).*
Bazuar në faktin 1 konkretisht dokumentet të cilat mi ka dërguar personi përgjegjës AK të siguruara paraprakisht me anë të kërkesës për informacione shtesë nga OE i propozuar për kontratë i ka dërguar tek AK-ja një fajll në PDF prej 119 faqeve, ku janë të bashkangjitura: Deklarata nën betim e skanuar në kolor (NTSH Eling), fatura, urdhërblerje, kartelat bankare si deshmi që janë inkasuar punët e realizuara sipas kontratave dhe urdhërblerjëve, deshmi për listen e stafit dhe librezat e qarkullimit te makinerive me të cilat posedojnë.
Konstatoj se në kartelen bankare te bashkangjitur nga OE i rekomanduar për kontratë janë te evidentuara te gjitha pagesa për: mall, shërbim dhe punë të kryera për KEDS-in. Fatura te lëshuara në bazë te kontratave te cekura me numer dhe me data te nënshkrimit, nga Projekti: "Përforcimi dhe zgjërimi i rrjetit në Distriktin e Pejës dhe disa për distriktin e Mitrovices, Ferizajit, Prishtinës" etj... vlera e të cilave i tejkalon vlerën minimale te kërkuar në "Njoftimin për Kontratë" dhe në "Dosjen e Tenderit" mirëpo të cilat nuk përkojnë me natyrën e kontratës.
Nga DT e dorëzuar nga OE te propozuar për kontratë, tek dokumenti **"referenca 1.pdf"** faqe 41, është nje referencë nga **"Bechtel Enka"** që mbanë datën 26.09.2016 e cila është irelevante pasi që është ma e vjetër se 3 vite nga data e publikimit te "Njoftimit për Kontratë" nga AK, te cilën nuk e kam marrë parasysh.
Në faqen 42 të po të njejtit dokument është një referencë nga **"KEDS"** për punët e kryera për projektin "Furnizim me Material Elektrik" nga kjo pjesë merret si relevante vetëm urdhër-blerja 79-1/02 e datës 07.03.2017 e cila është brenda afatit të kërkuar nga ana e AK-së në DT, e cila tek tabela e cila përmbanë listen e punëve dhe projekteve të përfunduara te kompanisë "Eling" gjendet nën numrin rendor **89**, në vlerë të përgjithshme: **15,670.38 euro**.
Po ashtu nga DT e dorëzuar nga OE të propozuar për kontratë, tek dokumenti **"referenca 2.pdf"** faqe 53, është nje referencë e lëshuar për **OE "NABS" SHPK** që është pjesë e grupit te OE te propozuar për tu shpërblyer me kontratë dhe e cila ka të bejë me kontraten me titull: "***Ndërtimi i miniparqeve, furnizimi dhe vendosja në***

hapësira publike e koshave për plehra dhe ndriqimi publik ne Komuna e Prizrenit" me vlerë totale: **289,124.00 euro**, e cila deri në ditën e lëshimit te kësaj reference datë: 13.09.2019, pra kontrata ende e papërfunduar ka arritë në vlerën prej total: ***209,594.00 eur***. E cila edhe nëse merret parasysh si pjesërisht e natyrës së njejtë së bashku me referencen e **OE "Eling"** nuk janë të mjaftueshme për ta plotësuar kërkesen per kapacitetin teknik dhe profesional.
Në komplet dokumentacionin e dorëzuar nga OE te rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë si dhe në dokumentin e dërguar si përgjigje në kërkesë për informacione shtesë, nuk ka asnjë Referencë tjetër e cila e deshmon vlerën e punëve të kryera apo procesverbal të pranimit përfundimtar të punëve, shuma e të cilave do ta plotësonte kërkesen obligative, konkretisht Pikat 9.1 & 9.2 të DT "Kapaciteti teknik dhe profesional".
Andaj e rekomandoj P.SH. të OSHP-së që ta aprovoj **si të Bazuar** ketë pretendim ankimor të OE ankues sepse grupi i OE të shpërblyer për kontratë nuk ka ofertuar në harmoni dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 5:
Ne dosje të tenderit eshte kërkuar certifikata e biznesit se bashku me informatat e biznesit, mirepo operatori ekonomik nuk e ka permbushur as kete kerkesë sepse nuk ka ofruar informatat mbi biznesin.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionëve të dorëzuara nga grupi i OE te propozuar për tu shpërblyer me kontratë për **pretendimin 5** dhe bazuar në faktin 9 të kësaj ekspertize, pas shikimt te dosjeve të dorëzuara nga grupi i OE te propozuar për tu shpërblyer me kontratë konfirmoj se për te dy operatorët pjesë e këtij konzorciumi i kanë bashkangjitur vetëm fletat e para te certifikatave te biznesit pa informata përcjellëse e që nuk është në përputhje me piken 1 te "Kërkeses për pershtatshmerinë Profesionale" andaj konsideroj që pretendimi 5 i OE ankues është **i Bazuar** dhe si i tillë propozoj qe edhe të Aprovohet nga ana P.SH. të OSHP-së, edhe pse AK-ja ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimet ankimore 6 dhe 10:
Ndriçuesit e ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontrate nuk jane ashtu sikur në paramase, nuk janë specifikuar në katalog me cilët ndriçues oferton firma, sepse ne katalogun e ofruar ka ndriçues të ndryshem, por jo edhe ashtu siç është e specifikuar në dosje të tenderit.
Nuk është marr parasysh (Kerkesa 4 a-Dëshmia 4 a) ku kërkohet që Operatori Ekonomik ta paraqes katalogun me produktet e ofruara, në katalog specifikat e produktit duhet të jenë të paraqitura dhe lehtë të verifikueshme.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, dokumentacionëve të dorëzuara dhe faktit 10 të kësaj ekspertize, konfirmoj qe OE i propozuar per tu shperblyer me kontratë ne Dosjen e tij të dorëzur nder te tjera edhe dokumentin me titull **"9. katalogu.pdf"**, dokument prej 22 faqeve i prodhuesit Kinez ZGSM, përfaqësues i autorizuar i të cilit për Kosovë është "NABS" SHPK, që është pjesë e grupit te OE te propozuar për tu shperblyer me kontratë, dhe ne ketë katallog ka të perfshirë pajisje me karakteristika dhe specifika te kerkuara nga AK ne DT dhe Njoftim për Kontratë, duke marrë në konsiderim edhe dokumentin **"oferta 27.11.PDF"** e nënshkruar dhe vulosur nga ana e OE te propozuar për kontratë, konsideroj se kjo pikë plotësohet, mirëpo produktet e ofruara nga grupi i OE nuk janë lehtësisht te verifikueshme nga katallogu e as te shenjëzuara saktësisht, gjë qe paraqet problem si për komisionet ashtu edhe per mua verfikimi i saktë i produkteve te katallogut me produktet dhe specifikat e tyre te kërkuara në paramasë, andaj e propozoj P.SH. që keto dy pretendime ankimore ti aprovoj si **Pjesërisht të Bazuara.**

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 7:
OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar certifikata te cilat nuk kanë asnje mundesi verifikimi, andaj AK-ja eshte dashur ti verifikoj dhe ti sqaroj siç duhet këto certifikata, po ashtu OE i lartpermendur nuk ka ofruar katalog per sistemin e menaxhimit te ndriçueseve, andaj nuk e plotëson as kete kerkesë, ne jemi të çuditur se si AK-ja ka mundur te rekomandojë për kontratë këtë OE i cili është i papergjegjshem.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të DT dhe dokumentacionëve të dorëzuara nga grupi i OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë dhe faktit 8 dhe në faktin 11 të kësaj ekspertize **"Paramasa" (pikat 6, 7, 8 dhe 9)**, ka te bejë pikërisht me vërjen ne funksion te kontrollerit intelegjent dhe softuerit aplikativ për

menaxhim të këtyre trupave ndriçues. Po ashtu edhe në faktin 10, kërkesa për katallog te produkteve.
Në faqen 22 te katallogut të ofruar nga OE, është edhe përshkrimi i sistemit te menaxhimit te ndriçuesve nga prodhuesi i tyre, si në foto më poshtë:

Lighting systems



Intelligent Control System

ZGSM provides a total solution for intelligence street lighting system.
ZGSM street light intelligence system is made up by software, gateway, single light controller. The gateway is installed in the distribution cabinet, the single light controller is installed in the lighting terminal. It proceeds with communication via GPRS/ CDMA/ WCDMA wireless network or cable network & monitor center and proceeds with communication via ZIGBEE/ LORA.

Gateway can control each single light controller via receiving, executing, forwarding PC management software, which can control each lamp's switching on/ off or dimming, then save electric energy. It can also monitor the lamps' electric energy to achieve failure lamps function. Gateway can built-in DO to achieve street light loop control, it can connect with other equipment to collect local illumination, temperature and other information, feedback to PC management software and achieve to monitor the current information.
At present, all our series of LED street lights can be combined with the intelligence street lighting system...
If you want to know more, please contact ZGSM Team.

39 | *Lighting systems* www.zgsm-china.com | rain@zgsm-china.com

I cili i plotëson kërkesat e AK-së, andaj konsideroj se kjo pjesë e këtij pretendimi ankimor **është e Pabazuar.**
Sa i përket certifikatave të kërkuara nga AK: Certifikata ISO 90001 e prodhesit te produkteve. Ceritifikata ISO 140001 e prodhuesit te produkteve. Certifikata ENEC për produktet e ofertuara. Certifikata IEC për produktet e ofertuara, janë edhe të dorëzuara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë andaj edhe këtë pjesë të pretendimit ankimor e konsideroj **si të Pabazuar**, rrjedhimisht e rekomandoj P.SH. që këtë pretendim ankimor të OE ankues ta hedhë poshtë **si të Pabazuar.**

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 8:
Ne dyshojme edhe ne autorizimin e prodhuesit se eshte origjinal, prandaj kerkojme te verifikohet.

Eksperti shqyrtues teknik bazuar në faktin 8 "***Komunikimi i Ekspertit me prodhuesin e trupave ndriçues***

LED" dhe konfirmimin nga prodhuesi i trupave ndriçues për autencitetin e autorizimit, e konsideroj këtë pretendim ankimor si **të Pa bazuar** dhe si të tillë e rekomandoj edhe P.SH. te OSHP-së që ta hedhë poshtë.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 9:
Operatori ekonomik "NABS SH.P.K. & ELING" në dokumentacionet e tij, ne katalogun e prezentuar nuk ka ofruar dëshmi për produktet, si në vijim: pajisjes për komunikim në mes të llambave dhe qasjes në Web site perkatës (GATEWAY-IT), kontrollerit inteligjent

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe bazuar edhe ne pergjigjen në pretendimin ankimor 7, konsideroj se në katallogun e grupit te OE te rekomanduar për kontratë është ofruar deshmi e mjaftueshme qe në ofertë janë të përfshira edhe produktet përcjellëse te cilat e vejnë në funksion kontrollerin intelegjent te trupave ndriçues. Andaj ketë pretendim ankimor ia rekomandoj P.SH. qe ta hedhë poshtë **si të Pa Bazuar**.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimet ankimore 11 dhe 12:
Operatori ekonomik "NABS" SH.P.K. & "ELING" është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ka paraqitur listën prej 11 te punësuarve, por nuk ka prezentuar edhe dëshmitë e kualifikimit profesional-diplomat për secilin prej tyre, ai në fakt ka prezentuar vetëm 3 kualifikime profesionale-diploma nga 10 punëtorët e prezentuar. Ndërsa për njërin nga punëtorët, i cili gjendet në listën e të punësuarve nuk ka prezentuar as dëshminë e kualifikimit profesional-diplomën, as kontratën e punës dhe as përvoja e punës për këtë punëtor nuk figuron askund. Dëshmitë mbi kualifikimin e stafit-diploma, përvoja në punë, kontratat e punes janë në mënyrë precize të kërkuara për secilin punëtor sipas dosjes së tenderit. (Kërkesa 2 b-Dëshmia 2 b).

Nuk është prezentuar referenca për menaxherin e kontratës, ashtu si është përcaktuar me kriterin në dosjen e tenderit Kërkesa 2 a –Dëshmia 2 a. Të gjitha kontratat që kompania "NABS" SH.P.K. & "ELING" i ka lidhë me punëtorët e saj dhe që i ka prezentuar si dokumente janë pa nënshkrime të vet punëtorëve. Prandaj, nuk janë valide këto kontrata.

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga grupi i OE te rekomanduar për tu shpërblyer me kontratë dhe faktin 12, dhe bazuar ne pikat 9.1 dhe 9.2, respektivisht "kapaciteti teknik dhe profesional" te DT, pika b. *"Në kuadër të stafit të punës duhet të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës"*. OE "NABS" SHPK, në dosjen e tij të dorëzuar, ka ofruar listen e punëtorëve te nxjerrë nga sistemi i ATK-së ku figurojnë 11 të punësuar si punëdhenës primar dokumenti **"8.lista e punetorve.PDF"**, fajllin **"dokumente per sqarime te tenderit.pdf"**, te derguar nga OE tek AK, është tabela me listen e stafit e panënshkruar, është vendimi dhe diploma për menaxherin, por mungon referenca e kërkuar, gjithashtu të gjitha kontratat e ofruara si në dosjen e dorëzuar ashtu edhe në përgjigjen në kerkesën për informata shtesë janë te panënshkruara nga punëtorët.
Këto pretendime ankimore i konsideroj si **pjesërisht të Bazuara** dhe si të tilla ia rekomandoj edhe P.SH. ti aprovoj.

Duke pasur parasysh të gjitha përgjigjet në pretendimet e lartcekura si dhe në dëshmitë që u përmendën më lartë eksperti teknik dhe ai shqyrtues konstatojnë se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 1, 7, 59, 60,72 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në faktet, të gjeturat, sqarimet e lartpërmendura etj. eksperti shqyrtues dhe ai teknik i propozojnë Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si **Pjesërisht e Bazuar** dhe të obligohet AK që ta anuloj Njoftimin për Shpërblim me Kontratë dhe lendën ta kthejë në **Rivlerësim**.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **Kuvendi Komunal i Prizrenit**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **OE "MULTI BUSINESS GROUP" SH.P.K. – Prizren**